

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbim

**“PËR MIRATIMIN DHE ARGUMENTIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
TË KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbim i Zhvillimit të Mirëmbajtjes së Programit të Taksave dhe Tarifave Vendore”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CVP):
50324100-3.

VLERA E FONDIT LIMIT: 5,805,444 (pesë milion e tetëqind e pesëmijë e katërqind e dyzet e katër) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohet në nenin 82 dhe 83 të LLP-së Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, si dhe nenet 14, 15, 25, 26 të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga

autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3:

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, në të cilën është e parashikuar se: *Pika 1 Neni 83: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.” Pika 2 Neni 83: “Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës”, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LLP-së Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 41, të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është vendosur në përputhje me nenin 77, pika 1/b dhe pika 3, e LPP-së Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, pasi është në të drejtën e Autoritetit Kontraktor të vendosi kërkesa të cilat garantojnë se operatorët ekonomik pjesëmarrës kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën si dhe në nenin 43 të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vjetet e fundit financiarë.”* Gjithashtu në përputhje me nenin 55, pika 4, paragrafi 1 dhe 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021

“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.”

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2026, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.

Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do ti kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve të deklaruar si më lart.

Argumentimi: Në lidhje me Vërtetimin për likuidimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, kërkesa e mësipërme është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” të ndryshuar dhe në përputhje me nenin 76, pika 2 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2026, sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, konkretisht me Ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” të ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari tregtare, kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të

kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

ose

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur sipas përcaktimeve bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar si dhe të nenit 40, pika 4 dhe nenit 55, pika 4/b., të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, pasi është në të drejtën e Autoritetit Kontraktor të vendosi kërkesat të cilat garantojnë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për ta zbatuar kontratën.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor janë kërkuar vërtetimin për realizimin e kontratave të ngjashme në përputhje me bazën ligjore të sipërpërmendur për të vërtetuar që ofertuesi/ofertuesit pjesëmarrës ka/kanë përvojën e duhur, ka/kanë kapacitetet e duhuara si teknike dhe organizative për të realizuar një kontratë të tillë. Paraqitja e vërtetimit për realizimin me sukses të kontratave të ngjashme nga ana e Operatorit Ekonomik dëshmon me korrëktësi në përmbushjen me sukses të detyrimeve kontraktore të Operatorit Ekonomik në raste të tjera të ngjashme si në cilësi ashtu dhe në afatet duke krijuar besueshmëri te Autoriteti Kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës.

Në bazë të këtij kriteri operatorët ekonomik vërtetojnë eksperiencën në fushën objekt prokurimi dhe autoriteti kontraktor merr garancinë e nevojshme që shërbimi do të realizohet me sukses. Përvoja e operatorit ekonomik është një element shumë i nevojshëm për autoritetin kontraktor për të vërtetuar qëndrueshmërinë ekonomike të ofertuesit, eksperiencat dhe besueshmëria në përmbushjen e suksesshme të kontratës. Për kontratat e realizuara nga operatori ekonomik, operatori duhet të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar me qëllim të shërbejë autoritetit në vlerësimin sa më të qartë të kriterit për eksperiencat e ngjashme.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë një punësim mesatar të paktën 7 (shtatë) punonjës të punësuar, të cilët të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për të paktën muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën për muajin e fundit të deklaruar, shoqëruar me formularet e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për punonjësit është vendosur sipas përcaktimeve të nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 4, gërma “c” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Kërkesa specifike për stafin e kërkuar është përcaktuar që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Për të përcaktuar numrin e punonjësve të nevojshme për realizimin e kontratës është bërë analize mbi afatin e realizimit të shërbimit, mbi llojin e shërbimit, mënyren si do të realizohet, volumin e punës për kryerjen e këtij shërbimi, si dhe instensitetin e rëndësinë e jashtëzakonshme të sistemit, pasi mos realizimi me sukses i saj sjell dëme të konsiderueshme për institucion. Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky është një numër minimal i kërkuar për të vërtetuar kapacitetin e fuqisë punëtore që duhet për të bërë të mundur realizimin në kohë dhe me sukses të kontratës.

2.3.3 Për të garantuar implementimin me sukses të kontratës, cilësinë e shërbimit të ofruar si dhe për të garantuar suportin përgjatë periudhës së parashikuar të mirëmbajtjes sipas dokumentit të termave të referencës, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë staf të kualifikuar të diplomuar në një nga degët e Inxhinierisë Elektronike, Inxhinieri Informatike, Teknologji Informacioni, Informatikë, Informatikë Matematikë, Inxhinieri Matematike dhe Informatike, Informatikë Ekonomike, Telekomunikacion, Inxhinieri Telekomunikacion, me kompetencat minimalisht si më poshtë:

- a) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për administrimin e bazës së të dhënave ose ekuivalente.
- b) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për Testim Software ose ekuivalente.
- c) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për zhvillim software ose ekuivalente.

Një punonjës mund të ketë 1 ose më shumë certifikime.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Diplome përkatëse
- Certifikata/ Transkriptet përkatëse për specialistët e kërkuar;
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik/ profilin e punonjësve nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetedeklarimit, sipas shtojcës 10, pjesa III, pika B;
- Kontratë punë.

Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do ti kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve të deklaruar si më lart.

Argumentimi: Kërkesa për staf është hartuar në përputhje me nenin 41, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

a) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për administrimin e bazës së të dhënave ose ekuivalente.

Argumentimi për kërkesën sipas pikës a: a) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për administrimin e bazës së të dhënave ose ekuivalente. Certifikimi për administrimin e bazës së të dhënave, i ofron individëve aftësinë për të dizenuar, implementuar dhe menaxhuar databaza. Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor kërkon të garantojë që Operatori Ekonomik ofertues është i aftë për krijimin dhe administrimin e databazës dhe mirëmbajtjen eficiente të saj. Mënyra më e saktë dhe që minimizon risqet për konfirmimin e aftësive të stafit është pajisja me certifikata nga prodhuesit ose organet e pavarura, dhe paraqitja e tyre si dëshmi kualifikimi. Prania e tyre jep garanci për shërbimet e mirëmbajtjes dhe operimin e sigurtë me elementët përbërës të databazës për të gjitha të dhënat, realizimet dhe të dhënat operationale përkatëse.

b) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për Testim Software ose ekuivalente.

Argumentimi për kërkesën sipas pikës b: Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për Testim Software ose ekuivalente.

Kualifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor janë të domosdoshme për të garantuar një implementim, testim cilësor dhe dokumentim të sistemit informatik të kërkuar dhe proceseve të punës të cilat kërkohej të automatizohen. Këto kritere janë vendosur për të garantuar njohuri të plotë teknike të ofertuesve mbi sistemin informatik të propozuar në çdo nivel të tij, si në nivelin teknik ashtu dhe në përdorimin e tij. Kërkesat e kontratës përfshijnë dhe testimin e proceseve të implementuara duke siguruar që çdo gjë është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, Sa më sipër, është e nevojshme dhe e domosdoshme gjithashtu që përgjatë periudhës së mirëmbajtjes, zhvillimit t'i nënshtrohen një procesi të testimit në mënyrë që të eliminohen të metat/errorret në sistem. Për këtë arsye shërbimi i testimit duhet të udhëhiqet nga një specialist i cili zotëron kapacitetet dhe kualifikimin e nevojshëm për realizimin e testeve, duke garantuar mbarëvajtjen e sistemit me të gjithë komponentët përbërës dhe rrjedhimisht të kontratës.

c) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për zhvillim software ose ekuivalente.

Argumentimi për kërkesën sipas pikës c: c) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për zhvillim software ose ekuivalente. Kualifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor janë të domosdoshme për të garantuar një implementim mbi kërkesat për zhvillim në Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore gjatë periudhës së kohezgjatjes së kontratës. Këto kritere janë vendosur për të garantuar njohuri të plotë teknike të ofertuesve

mbi sistemin informatik, si në nivelin teknik ashtu dhe në përdorimin e tij. Sa më sipër, është e nevojshme dhe e domosdoshme gjithashtu që përgjatë periudhës së mirëmbajtjes, nëse lind nevoja për zhvillim, të kenë aftësi profesionale dhe teknike për të bërë të mundur realizimin e kërkesave nga Autoriteti Kontaktor për zhvillime sistemin informatik. Për këtë arsye shërbimi i zhvillimit duhet të udhëhiqet nga specialist i cili zotëron kapacitetet dhe kualifikimin e nevojshëm.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë partneritet të vlefshëm me Oracle ose një partneritet tjetër ekuivalent me prodhuesin e sistemit të menaxhimit të bazës së të dhënave Oracle, i cili garanton realizimin e objektit të prokurimit, si dhe mirëmbajtjen dhe funksionalitetin e bazës së të dhënave Oracle Database.

Për vërtetimin e plotësimit të kësaj kërkesë, operatori ekonomik duhet të paraqitë një ose më shumë nga dokumentet e mëposhtme:

- Certifikatën e vlefshme Oracle Partner; dhe/ ose,
- Një deklaram/ konfirmim zyrtar të Oracle; dhe/ ose,
- Një komunikim zyrtar (shkresë ose e-mail) të Oracle ose të distributorit/ partnerit të autorizuar të saj; dhe/ ose,
- Një dokument tjetër ekuivalent që provon ekzistencën e partneritetit ose autorizimit.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë aplikacionet, licencat dhe mjedisin (ambientin) e zhvillimit Unify SQLWindows 5.1 dhe/ ose çdo mjedis tjetër zhvillimi ekuivalent, i cili mundëson zhvillimin, mirëmbajtjen dhe implementimin e aplikacionit objekt prokurimi.

Për vërtetimin e plotësimit të kësaj kërkesë, operatori ekonomik duhet të paraqitë një ose më shumë nga dokumentet e mëposhtme:

- Licencën ose certifikatën për përdorimin e mjedisit të zhvillimit; dhe/ ose,
- Një deklaram/ konfirmim zyrtar të prodhuesit ose distributorit të autorizuar; dhe/ ose,
- Një kontratë të ngjashme, të përfunduar ose në zbatim, nga e cila vërtetohet se operatori ekonomik ka zhvilluar ose mirëmbajtur aplikacione duke përdorur mjedisin e zhvillimit Unify SQLWindows 5.1 ose një mjedis ekuivalent.

Argumentimi: Kriteret e përcaktuara në pikat 2.3.4 dhe 2.3.5, janë bazuar në pikën 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, si dhe pikës 4 të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, të cilat parashikojnë të drejtën e autoritetit kontraktor për të kërkuar prova për aftësinë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë, kur këto lidhen drejtpërdrejt me realizimin e kontratës, në përpjesëtim me objektin e saj.

Objekti i prokurimit përfshin zhvillimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit Informatik të Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Tiranë, i cili është i zhvilluar në mjedisin Unify SQL Windows dhe funksionon mbi bazën e të dhënave Oracle Database. Për shkak se baza e të dhënave Oracle përbën komponentin kryesor të infrastrukturës teknologjike mbi të cilën operon sistemi, është e nevojshme që operatori ekonomik të ketë akses në mbështetjen teknike, dokumentacionin, përditësimet, praktikat dhe standardet e prodhuesit.

Partneriteti me Oracle ose me një partner të autorizuar të Oracle garanton se operatori ekonomik disponon njohuritë, autorizimet dhe mbështetjen e nevojshme për të kryer ndërhyrje teknike, për të siguruar vazhdimësinë e funksionimit të sistemit dhe për të adresuar problematika që lidhen me bazën e të dhënave gjatë periudhës së zbatimit të kontratës.

Njëkohësisht, kërkesa për disponimin e aplikacioneve, licencave dhe mjedisit të zhvillimit Unify SQLWindows 5.1 ose një mjedisi tjetër ekuivalent është e nevojshme për të garantuar që operatori ekonomik disponon mjetet teknike të nevojshme për zhvillimin, mirëmbajtjen, testimin, implementimin dhe përditësimin e aplikacionit objekt prokurimi, pa cënuar funksionalitetin dhe vazhdimësinë e sistemit ekzistues.

Autoriteti kontraktor vlerëson se këto kërkesa janë të lidhura drejtpërdrejt me natyrën, kompleksitetin dhe specifikat teknike të objektit të prokurimit, pasi mungesa e partneritetit me prodhuesin ose e mjedisit të nevojshëm të zhvillimit do të cënonte mundësinë e operatorit ekonomik për të realizuar në mënyrë të plotë dhe cilësore detyrimet kontraktore.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standardin ISO 9001 (ose ekuivalente), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë përcaktuar bazuar në pikën 1, të nenit 79, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se:

“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit si dhe referuar nenit 44 pika 1., të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë, dhe mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusi i klientit, përshtatshmëria e burimeve të tij, kompetenca/ profesionalizmi i punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimi i cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimeve që ofron, garantimi i një procesi cilësor të furnizimit e shërbimit sigurimi i konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo

kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Përmbushja e standardeve ose ekuivalent është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.

(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes).

2.3.7. Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standardin ISO 20000 (ose ekuivalente) për sistemin e menaxhimit të shërbimit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 79 të LPP, nenit 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të shërbimit. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Standardi ISO 20000 (ose ekuivalent) përcakton kriteret për planifikimin, krijimin, menaxhimin, monitorimin, rishikimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e qasjes së menaxhimit të shërbimeve që fokusohen në teknologjitë e informacionit.

Përmbushja e standardeve ose ekuivalent është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik të demonstroj aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht shërbime që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve, pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit.

(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes).

2.3.8. Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standardin ISO 27001 (ose ekuivalente), për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 79 të LPP, nenit 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar

kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Ky standard specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit. Vlerësimi i rreziqeve të sigurisë së informacionit dhe veprimi ndaj këtyre rreziqeve (i ashtuquajtur i "trajtimit i rreziqeve") përmes kontrolleve të sigurisë së informacionit në pajtim me kërkesat e standardit përfaqësojnë një bazë të sigurt për të siguruar konfidencialitetin, disponueshmërinë dhe integritetin e informacionit përkatës dhe arritjen e objektivave të dëshiruara të sigurisë. Siguron një kornizë për zbatimin e politikave, procedurave dhe masave në proceset e menaxhimit të rrezikut të informacionit të organizatës. Nisur nga rëndësia e kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të sigurisë së informacionit, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht shërbime që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve, pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së .

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën/certifikatat ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

Argumentimi i specifikimeve teknike dhe termave të referencës.

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti. Sa më sipër, specifikimet teknike, janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Në specifikimet teknike përkufizohen karakteristikat siç janë përshkrim i të gjitha kushteve që duhet të plotësojë për llojin e shërbimit në mënyrë që operatorët ekonomikë të interesuar, të kenë informacion të plotë dhe të kenë mundësi të përmbushin kushtet e kriteret sipas specifikimeve të hartuara nga AK.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave. Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP, për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt.